




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KESHILLI



Nr. 481 / prot  
7

Koplik më: 28/06 / 2022

**V E N D I M**

*Nr 28 datë 27 / 06 / 2022*

**PËR**

1. "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Prel Vitaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Prel Vitaj nga programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr 70 datë 29.12.2022 "për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afat mesem 2022-2024 të Bashkisë Malësi e Madhe".

**Baza Ligjore**

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr.45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstytucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

**Vendosi;**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit z. Prel Vitaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe, për dëmtimin e banesë nga rënia e zjarrit.
3. T'i akordojë familjes së shtetasit Z. Prel Vitaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, dhënie të ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vlerën/shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr.70, datë 29.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Malësi e Madhe", nga fondi i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, nga Programi "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280".
4. T'i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit Z. Prel Vitaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
5. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Z. Prel Vitaj, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.

6. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit **Z. Prel Vitaj**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.

7. Vlera e dëmeve në orëndi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 283.900 (dyqind tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind) leke.

Dëmtime nga ana ndërtimore 2.353.416 (dy milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë)

Vlera në totale dëmeve është: 2.637.316 (dy milion e gjashtë qind tridhjetë e shtat mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) leke.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

**KRYETAR**

Ilir Halaj

**SEKRETAR**

Emirjan Hasmuja

Miratuar me 27.06.2022

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 29.06.2022

